të punuar në fushën e mitologjisë, të kulteve të besimeve popullore në përgjithësi dhe veçanarisht të besimeve popullore shqiptare këtu në Jugosllavi. Te ne me të vërtetë mungojnë jo vetëm studimet e këtij llojl, por edhe lënda e grumbulluar dhe e botuar nga kjo fushë.

DRITA STATOVCI
Instituti Albanologjik — Prishtinë

Prof. dr. Hivzi Islami, FSHATI I KOSOVËS, Botoi: Rilindja, Prishtinë 1985.

Kohë më parë në botim të Rilindjes doli studimi i H. Islamit „Fshati i Kosovës" që paraqet një kontribut të rëndësishëm demografiko-sociologjik të evolucionit rural te ne. Duhet cekur që në fillim se ky studiues shquhet pa dyshim për hulumtimin municioz si dhe për qëndrimin kritik në interpretimin e fakteve shkencore. Pas leximit të këtij studimi, gjithsesi do të njohim më mirë problemet e fshatit kosovar në të kaluarën, sot dhe perspektivën e tij në të ardhmen. Studimi është i koncipuar ashtu, që pas një parathënieje të thukët përfshin dy pjesë: *1. Fshati dhe shoqëria tradicionale kosovare dhe karakteristikat e tyre dhe 2. Çështje të transformimit shoqëror të fshatit kosovar.* Studimi përmban edhe një përfundim të ngjeshur mbi rrjedhën, problemet dhe perspektivën e evolucionit rural të Krahinës, pastaj jepet bibliografia dhe një shtojcë statistike me indikator më të rëndësishëm të zhvillimit rural sipas komunave, që ka vlera të mëdha për nevoja praktike.

Në pjesën e parë, që përbëhet prej dy kaptinave, bëhet fjalë për fshatin tradicional kosovar deri në Luftën e Dytë Botërore. Në fillim autori bën fjalë për të kaluarën demografike të Ballkanit Qendror që nga Iliret deri në ditët tona. Duke u bazuar në fakte të qëndrueshme shkencore, autori tezën e Cvijiqit dhe të ithtarëve të tij mbi gjoja ardhjen e shqiptarëve në Kosovë nga Shqipëria Veriore në shek. XVII e XVIII e hedh poshtë si të pabazë. Për fat të keq, edhe sot disa pseudoshkencëtarë e përdorin një tezë të tillë për qëllime të caktuara tendencioze.

Duke u bazuar në rrethanat shoqërore-ekonomike, autori veçon dy tipe të fshatit; atë tradicional që është në shoqërinë paraindustriale dhe atë bashkëkohore që është në shoqërinë e zhvilluar industriale. Në periudhën në mes dy luftërave, fshati kosovar si edhe tërë Kosova, veçohej si një regjion tipik agrar, ku tërë popullsia jetonte nga bujqësia ekstensive. Bashkësia fshatare, si në pikëpamje sociale, ekonomike, profesionale, arsimore etj., ishte homogjene. Gjendja e tillë të mjeruar të fshatarësisë e rëndoi edhe më tepër reforma agrare, e cila, si qëllim të fundit, kishte kolonizimin e Kosovës dhe shpërnguljen e shqipëtarëve në Turqi e Shqipëri, proces ky i cili, në forma të modifikuara e të maskuara, në rrethana të reja shoqërore-politike, vazhdoi edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Si rezultat i një prapambeturie ekonomike e shoqërore, fshati kosovar veçohej me mobilitet të pamjaftueshëm dhe të kufizuar hapësinor, me natalitet dhe mortalitet të lartë, me popullsi të tërë analfabete etj. Dominonte familja e madhe patriarkale me rregullimin fisnor, sips te drejtave zakonore te kanunit të Lekë Dukagjinit. Nga një gjendje e tillë që ishte fshatarësia, i bënte rezistencë edhe inovacioneve, sepse nuk ishte në gjendje të kuptojë rëndësinë e tyre në transformimin e fshatit.

Pjesa qendrore e studimit është pjesa e dytë ku bëhet fjalë për transformimin shoqëror të fshatit pas Luftës së Dytë Botërore deri në ditët tona, që përbëhet nga pesë kaptina. Në këtë periudhë të zhvillimit shoqëroro-ekonomik, në mënyrë të pavolitshme ka ndikuar gjendja e trashëguar nga periudha e paraluf-

tës, por edhe ngecja në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik deri në vitet gjashtëdhjeta. Si rezultat i hyrjes së vonshme të Krahinës në rrjedhat e transformimit shoqëroro-ekonomik, këtë e veçon transizicioni demografik i vonuar. Më tutje bëhet fjalë për natalitetin, mortalitetin dhe shtimin natyror të popullsisë. Pasi Kosova ka shkallë te lartë të natalitetit, për zvogëlimin e tij është i domosdoshem zhvillimi ekonomik, shoqëror, dhe kulturor, sepse ndryshimet e mobilitetit kushtëzojnë me ndryshimet e veçorive sociale, profesionale, arsimore, shëndetësore etj. të popullsisë e të shoqërisë. Është i domosdoshëm në këtë drejtim ndryshimi i statusit të femrës në familje dhe në shoqëri, pavarësimi ekonomik dhe ngritja e nivelit kulturo-arsimor të saj, potencon autori. Praktika ka treguar se femra e zënë me punë dhe e arsimuar lind më pak fëmijë sesa ajo që nuk është në punë dhe e paarsimuar, pa marrë parasysh se cilit nacionaliteti i takon.

Vëmendje të posçme autori iu ka kushtuar edhe migrimeve të popullsisë. Pasi në të kaluarën popullata e Kosovës veçohej me shkallë të lartë të homogjenitetit, ajo shumë pak ka lëvizur nga vendi i lindjes. Këtu duhet përjashtuar migrimet e popullsisë të shkaktuara nga situatat e pavolitshme politike. Në këtë aspekt autori veçon tri faza të migrimeve; e para prej vitit 1878-1918, e dyta 1918-1941 dhe e treta 1945-1966. Rëndësi të madhe kanë migrimet fshat-qytet, ndërsa ato interrurale kanë më pak rëndësi. Migrimet s'do mend, kanë pasoja negative si për vendin e emigruar dhe atë të imigruar. Në lidhje me këtë, autori na jep një shembëll tipik, kur bën fjalë për Rugovën. Në transformimin e fshatit, rëndësi të madhe kanë migrimet ditore të fuqisë punëtore si dhe ato në botën e jashtme. Në fshat dominon popullsia e re për nga mosha, që paraqet një fenomen të veçantë në Evropë. Nga ana tjetër, sipas strukturës së gjinisë, në fshat dominon koeficienti i maskulinitetit. Me gjithë përpjekjet dhe të arriturat e mëdha në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës dhe veçanarisht të ngritjes së objekteve industriale e të infrastrukturës, Kosova edhe sot është territori më i pazhvilluar në Jugosllavi, ku dallimet e saj me territoret e tjera të vendit, jo vetëm që nuk po zvogëlohen, por po shtohen gjithnjë. Edhe pse janë arritur rezultate të mëdha në transformimin e fshatit, një pjesë e madhe e mirë e tyre edhe sot nuk kanë institucione elementare shoqërore, kulturore, shëndetësore, siç janë p.sh. bibliotekat, postat, shtëpitë e kulturës, objektet sportive rekreative, ambulancat etj.

Vend me rëndësi autori i kushton familjes, ekonomisë familjare dhe ekonomisë bujqësore. Ekonominë familjare shqiptare e ka veçuar familja e madhe patriarkale, ndërsa me kalimin e kohës, si rezultat i rrethanave të reja shoqërore, ajo bëhet bashkëkohore. Te familja e tillë, rol të rëndësishëm luan punësimi, arsimimi, dhe emancipimi i femrës. Në kapitullin e fundit të pjesës së dytë të këtij studimi, bëhet fjalë për çështjen e urbanizimit dhe të standardit të vendbanimeve fshatare. Një proces i tillë në Kosovë ka filluar të paraqitet pas viteve gjashtëdhjeta, e në veçanti pas atyre shtatëdhjeta, si rezultat i zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të Krahinës. Në këtë proces kanë ndikuar shumë faktorë. Këtu kemi parasysh rritjen dhe zgjerimin e strukturave të reja socialo-profesionale në fshat pastaj zgjerimin e objekteve infrastrukturale, risitë materiale dhe shpirtërore, risitë e banimit, të konsumit dhe të ushqimit. Ndonëse janë bërë ndryshime të mëdha, dallimet janë evidente nga fshati në fshat si dhe nga qyteti në qytet, që mund të vërehen edhe nga pamja fizionomike. Në këtë aspekt, migrimet intenzive në relacionin fshat-qytet, po krijojnë një varg problemesh në jetën shoqëroro-urbane të qytetit të Krahinës.

Është më se e domosdoshme që të punohet për përmirësimin e kushteve për të jetuar e punuar në fshat, që popullata të mbahet aty, duke i stimuluar me zhvillimin e

reparteve industriale sidomos asaj përpunuese, të veprimtarive terciale etj. Gjendja e tashme nuk toleron më luhatje, andaj duhet kujdesur për fshatin, sepse ai një gjë të tillë e meriton, pasi kështu siç është, ai është i lënë pas dore në krahasim me qytetin në çdo pikëpamje.

Studimi „Fshati i Kosovës" i H. Islamit është i pari i këtij lloji që i kushtohet studimit shkencor të fshatit, të strukturave dhe të jetës rurale. Një studim i tillë është si rezultat i punës disavjeçare të autorit. Nga sa u tha me lart, del se në të trajtohen një varg problemesh demografike sociologjike etj. Të gjitha këtyre problemeve autori u qaset në mënyrë empiriko-teorike. Përfundimet shkencore që ka ardhur autori në këtë studim janë origjinale dhe mund të shërbejnë si bazë solide për përparimin e mëtejmë të metodologjisë në rrafshin e studimit të fshatit dhe të jetës në të.

Gjatë hulumtimeve të bëra për prezentimin e këtij studimi, autori përfshin ecurinë në një periudhë të gjatë kohore (pothuaj një shekull) dhe të dhënat i parashtron në komparacion me ecurinë përkatëse në tërë vendin. Në këtë mënyrë arrin shkallë më të lartë të objektivizimit të përfundimeve dhe të parashikimeve të veta

Studimi „Fshati i Kosovës" i H. Islamit shfaq pretendime për një qasje të gjithanshme, për çka edhe ia ka arritur qëllimit. Kështu mënyra e qasjes, argumentimi teorik i problemeve, përdorimi i një aparature adekuate terminologjike si dhe pretendimet për një shtrim të gjithanshëm të problemeve, e bëjnë studimin më interesant dhe më me vlerë.

Na mbetet në fund për të thënë se libri është si rezultat i një përkushtimi serioz shkencor, që shprehet me gjerësinë e lëndës së përfshirë, në seleksionimin dhe sistemimin e saj, në qartësinë dhe saktësinë e shtrimit të arguentimit të problemeve në tërësi, çka dëshmon për pjekurinë e një autori të zellshëm që tashmë ka formuar individualitetin krijues në lëmin e krijimit shkencor.

NAIL DRAGA

Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Prishtinë

Fatos Arapi, **KËNGË TË MOÇME SHQIPTARE**. Studime. Botoi Shtëpia botuese „Naim Frashëri", Tiranë 1986, f. 386.

Përkundër faktit që në fushën e studimit të epikës gojore shqiptare janë arritur rezultate të rëndësishme, prapëseprapë ka mbetur edhe shumë punë për t'u bërë, si në planin e studimit të fenomenit epik në përgjithësi, ashtu edhe të llojeve e të krijimeve të veçanta të saj. Themi kështu, pos tjerash për dy arsye. E para: mënyrës se si janë parë dhe si janë vështruar disa probleme të epikës gojore shqiptare nga disa studiues (të huaj e shqiptarë), me plot të drejtë mund t'i bëhen vërejtje e kritika të shumta e të ndryshme, qoftë për qasjen pozitiviste që u është bërë disa problemeve të përgjithshme ose nënllojeve e krijimeve të veçanta (rrjedhimisht dhe rezultateve të tyre), qoftë për tendencat që janë shfaqur në disa shqyrtime të pjesëshme e sipërfaqësore kushtuar kësaj epike. Duke pasur parasysh këtë, shtrohet si gjë e domosdoshme zbatimi i studimit interdisiplinar, i qasjes moderne e komplekse të trajtimit të saj. E dyta: mbledhja dhe botimi i materialeve të reja epike, i shumë këngëve, versioneve e varianteve, përkatësisht i krijimeve të ndryshme me motive tashmë të njohura ose aspak të njohura, shtron nevojën e rivështrimit dhe të ripërkufizimit të shumë problemeve dhe të rezultateve të arritura në shqyrtimin, vlerësimin dhe hulumtimin e epikës gojore shqiptare.

Rrjedhimisht me këtë që thamë, po përmendim se një vepër e rëndësishme, që dëshmon se ende mund të bëhet shumë në fushën e studimit të epikës gojore shqiptare, është *Këngë të moçme shqiptare*